

VENDIM
Nr. 51, datë 7.3.2018

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “POWER ELEKTRIK SLABINJE”
SHPK, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ PRANË “RAIFFEISEN BANK”
SHA**

Në mbështetje të nenit 16; të nenit 20, pika “a”, të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; në zbatim të nenit 7 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; të pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 99, datë 17.6.2016, si dhe të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., për lënien peng të aseteve në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 151, datë 28.9.2017, ka vendosur fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Power Elektrike Slabinje” sh.p.k., për lënien peng të aseteve, për garantimin e detyrimeve të kredisë që kjo shoqëri ka ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

- ERE, nëpërmjet shkresës me nr. 233/3 prot., datë 5.10.2017, ka njoftuar shoqërinë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k. për plotësimin e dokumentacionit të munguar, të konstatuar në vendimin nr. 151, datë 28.9.2017.

- Shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., me shkresën nr. 180 prot., datë 31.10.2017, ka plotësuar pjesërisht dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., me shkresën nr. 186 prot., datë 24.12.2017, kërkoi nga ERE shtyrjen e afatit të mbledhjes së bordit deri në miratimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të transferimit të aseteve në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a.

- Shoqëria “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k., me shkresën me nr. 192 prot., datë 22.2.2018, ka përcjellë në ERE shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me nr. 45/3 prot., datë 20.2.2018, ku miratohet transferimi i aksioneve ose i aseteve pjesë të kapitalit.

- Aplikimi plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “j”, “k”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Neni 7, pika 3, është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Power Elektrik Slabinje” sh.p.k. për lënien peng të aseteve në favor të “Raiffeisen Bank” sh.a. (lista bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**Lista e aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të lëna peng në favor të “Raffaisen Bank”
sh.a., nga shoqëria
“Power Elektrik Slabinje” sh.p.k.**

1	Turbinat e ujit dhe pajisjet e shpërndarjes dhe instalimit	copë 10
2	Sistemi i kontrollit dhe pjesët përbërëse	copë 4
3	Sistemi i komandimit, 3 njësi me pjesët përbërëse	copë 2
4	Paneli i frenimit, 3 njësi me pjesët përbërëse	copë 1
5	Pajisje e impulsit KL-46, 3 njësi me pjesët përbërëse	copë 3
6	Valvul 700KD41H-25VK	copë 1
7	Komutator i tensionit të lartë, 6 njësi me pjesët përbërëse	copë 5
8	Valvul 900KD41H-25VK, 2 njësi me pjesët përbërëse	copë 2
9	Kabllo e tensionit të lartë 900 m,	copë 3
10	Kabllo e tensionit të ulët 18620m,	copë 9
11	Gjenerator SFW4300-8/2150, 1 njësi me pjesët përbërëse	copë 8
12	Gjenerator SFW2400-6/1430, 2 1 njësi me pjesët përbërëse	copë 5
13	Transformator S9-160, 3 njësi me pjesët përbërëse	copë 1
14	Transformator S6300-121, 2 njësi me pjesët përbërëse	copë 9
15	Transformator s3200-110, 1 njësi me pjesët përbërëse	copë 10
16	Turbinat e ujit dhe pajisjet e shpërndarjes dhe të instalimit	copë 11
17	Pajisje 100 kV, 1 njësi me pjesët përbërëse	copë 5
18	Vinç, 1 njësi me pjesët përbërëse	copë 12
19	Fiber optike 24200 M dhe pjesët përbërëse	copë 12